



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2, shkronja j e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 7 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, nr. 04/L-010, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, merr këtë

V E N D I M

- Miratohet** nisma e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal.
- Sipas pikës 1 të këtij vendimi, bashkëpunim ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet Komunave, si në vijim:
 - Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës;
 - Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komunës së Obiliqit dhe Komunës së Podujevës.
- Autorizohet Kryetari i Kryeqytetit që të fillojë konsultimet me komunat e cekura në pikën 2 të këtij Vendimi, për përgatitjen dhe nënshkrimin e propozim-marrëveshjes për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal ndërmjet njëra-tjetrës, me qëllim të realizimit të projektit "Ndërtimi i rrugës: Barilevë - Kozaricë - Dumnicë e Epërme - Kunovik - Veskoc - Kurillovë - Bajgorë".
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë e tjera relevante.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-030/01-54381/24 më 26.4.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Faqe 1 nga 1